



KUVENDI I SHQIPËRISË
Komisioni për Politikën e Jashtme

Dokument parlamentar

RAPORT

PËR PROJEKTLIGJIN

**“PËR RATIFIKIMIN E MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
REPUBLIKËS FEDERALE TË GJERMANISË, PËR BASHKËPUNIM TEKNIK
2018 PËR PROJEKTIN “MBËSHTETJE PËR NEGOCIATAT PËR
ANËTARËSIM TË SHQIPËRISË NË BE NË SEKTORIN EKONOMIK”**

- **Hyrje**

Komisioni për Politikën e Jashtme, në cilësinë e Komisionit për dhënie mendimi, në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit, shqyrtoi projektligjin “Për ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunim teknik 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”.

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit për të prezantuar projektligjin dhe për t’u dhënë shpjegime pyetjeve të deputetëve ishin Zv. Ministrija e Financave dhe përfaqësues të ministrisë së financave.

- **Baza kushtetuese e projektligjit**

Projektligji i paraqitur për shqyrtim është propozuar nga Këshilli i Ministrave, sipas përcaktimeve të neneve 78, 83, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Ratifikimi i kësaj marrëveshje bazohet në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Kreu II “Marrëveshjet Ndërkombëtare”, neni 121 i saj.

- **Qëllimi dhe përmbajtja e projektligjit**

Projektligji ka si qëllim ratifikimin e marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë, për bashkëpunimin teknik 2018 për projektin “Mbështetje për negociatat për anëtarësim të Shqipërisë në BE në sektorin ekonomik”.

Kjo marrëveshje është propozuar nga Republika Federale e Gjermanisë, nisur nga dëshira për t’i forcuar e thelluar marrëdhëniet miqësore midis dy vendeve nëpërmjet bashkëpunimit teknik, me qëllim për të kontribuar në zhvillimin social dhe ekonomik në Republikën e Shqipërisë, duke iu referuar premtimit financiar të Republikës Federale të Gjermanisë në protokollin e bisedimeve qeveritare të datës 22.10.2018.

Objektivi kryesor i zbatimit të këtij projekti është forcimi i kompetencave për zhvillimin e bisedimeve për anëtarësim në BE, me fokus në disa kapituj të caktuar të legjislacionit të BE-së, që i përkasin sektorit ekonomik. Mbështetja dhe zbatimi i këtij projekti është me shumë interes për vendin tonë në kuadrin e zhvillimit të negociatave për anëtarësim.

Për sa i takon shpenzimeve financiare, Qeveria e Republikës Federale të Gjermanisë vë në dispozicion për projektin shërbime në personel dhe materiale, si dhe eventualisht kontribute financimi (grante) në një vlerë të përgjithshme prej 2 000 000 (dy milionë) eurosh.

Nga ana tjetër, Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë merr përsipër të përballojë pagesën e TVSH-së (rreth 65 000 euro) nëpërmjet institucionit përfitues, në përputhje me nenin 3, të marrëveshjes, si dhe me vendimin nr.509, datë 12.08.1996, të Këshillit të Ministrave, “Për mënyrën e përballimit të TVSH-së, që lidhet me zbatimin e projekteve të financuara nga donatorë e organizma të ndryshëm ndërkombëtarë”.

Në marrëveshje përcaktohet se detajet e projektit si dhe detyrimet dhe shërbimet që duhet të kryhen, do të përcaktohen në kontrata të veçanta zbatimi dhe eventualisht financimi, që do të lidhen ndërmjet institucioneve. Angazhimet e marra në kuadër të këtij projekti dhe, referuar shumës prej 2.000.000 eurosh, do të zhvlerësohen pa kompensim, në rast se brenda katër viteve pas vitit të premtimit financiar nuk janë lidhur ende kontratat përkatëse të zbatimit dhe eventualisht të financimit.

Në marrëveshje parashikohen gjithashtu rregullat për hyrjen në fuqi, ndryshimin, shfuqizimin dhe interpretimin marrëveshjes.

- **Diskutimi në komision**

Të pranishëm në mbledhjen e Komisionit, për të shpjeguar nismën dhe për t’iu përgjigjur pyetjeve të deputetëve, ishin përfaqësues të përfaqësues të ministrisë së financave. Deputetët në komision pasi u informuan nga përfaqësuesit e ministrisë rreth projektligjit shprehën

vlerësimin e tyre ndaj kësaj nisme ligjore, si dhe ndaj ndihmës që Republika Federale e Gjermanisë i ofron nëpërmjet këtij projektligji Republikës së Shqipërisë.

Komisioni vlerësoi se **në aspektin ligjor**, projektligji i propozuar është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi dhe **në aspektin procedural**, është paraqitur në përputhje me Rregulloren e Kuvendit.

Në përfundim të diskutimeve, me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm e miratoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi dhe u shpreh dakord për kalimin e tij për votim në seancë plenare.

RELATOR

KRYETARE

ADNOR SHAMETI

MIMI KODHELI